




Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opstina Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

PROCESVERBAL

I mbajtur në Seancën e tretë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më 31.03.2016 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

- 2.1. Raporti financiar Janar-Dhjetor 2015,
- 2.2. Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 016-122568 e dt. 29.12.2015
- 2.3. Informatë rreth organizimit të Manifestimit tradicional “Flaka e Janarit” 2016,
- 2.4. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në Gjilan
- 2.5. Propozim vendimi për subvencionimin e aktiviteteve të Qendrës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve strehimorja “Liria” Gjilan
- 2.6. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Drita”
- 2.7. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Vollejbollistik “Drita” F
- 2.8. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Basketbollistik “Drita” M
- 2.9. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Gjilani”
- 2.10. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve.

3. Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10:20

Në punimet e seancës së tretë të vitit 2016 morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Përfaqësuesja e OSB-së, znj. Sadete Ternava-Osmani dhe Irfan Ukshini

Fazli Abdullahu, Koordinator i Zyrës Komunale për të Drejtat e Njeriut

Koordinator i Task Forcës për NJKRS, Bashkim Negjipi
Koordinator për Kulturë, Rini dhe Sport në NJKRS, Malazog Hoxha
Përfaqësuesi i OJQ “Lansdowne” Shaban Terziu
Mediat

Seancën e tretë të vitit 2016 e hapi dhe e udhëhoqi kryesueseje Kuvendit zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi e cila i përshëndeti të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë të cilët i monitorojnë punimet e kësaj seance.

Kryesuesja e Kuvendit kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të marrin një vendim për përjashtimin nga seanca e tretë e Kuvendit të anëtarit të Kuvendit z.Sergjan Mitrovicq edhe pse ai nuk ishte prezent.

Me 29 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 votë “abstenim” u miratua vendimi për përjashtim nga seanca e tretë e Kuvendit të z. Sergjan Mitrovicq.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar.

Në punimet e seancës së tretë ishin të pranishëm 32 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan –Jakup Bajrami, Bajram Hasani dhe Sergjan Mitrovicq

Procesverbali i seancës së kaluar pati vërejtje :

Arijeta Rexhepi: Në disa pika të rendit të ditës nuk janë shënuar fare fjalimet e disa anëtarëve të Kuvendit, por vetëm është cekur së këta anëtarë kanë marrë fjalën. Për mua është shumë e rëndësishme të thuhet ajo që është thënë, sepse ajo pjesë e debatit është dashur të jetë në procesverbal.

Aprovohet procesverbali i seancës së kaluar nga të gjithë anëtarët e Kuvendit me vërejtjen e dhënë.

Në vijim të punimeve, Kryesuesja e hapi debatin për rendin e punës.

Sahit Abazi- përshëndetje për të gjithë! Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ne jemi marrë veshë dhe kemi votuar që në seancën e Kuvendit të ditës së sotme si pikë e rendit të ditës të jetë Teatri dhe mënyra e pagesës së këshillave të fshatrave, prandaj është mirë të shikohet procesverbali i KPF-së, sepse ju keni thënë që në këtë seancë do të jenë në pika të rendit të ditës këto dy çështje, por këtu nuk janë, prandaj kjo është një vërejtje shumë serioze për të cilën uroj që mos të ketë qenë me tendencë por të ketë qenë ndonjë gabim teknik, sepse ne kemi votuar që me qenë pjesë e rendit të ditës këto dy pika. Sa i përket rendit të ditës që është tani, në emër të grupit të PDK-së, propozoj që pikat që kanë të bëjnë me subvencionime të futen në një pikë të përbashkët, në mënyrë që të lehtësohet seanca e KK-së. Andaj kërkoj nga ju që të lejohet diskutimi për Teatrin, për konkursin që është shpallë, dhe të lejohet diskutimi për këshillat e fshatrave, sepse ne jemi një Komision i përbashkët që po punojmë në themelimin e këshillave të fshatrave dhe ky është një proces që po ecë mirë, po ashtu pyetja e përhershme që bëhet pas çdo zgjedhje të këshillave të fshatrave është mënyra e pagesës, si do të bëhet ? Besoj se edhe kolegët e komisionit e kanë të qartë këtë punë. Shpresoj të gjejmë mirëkuptim dhe të lejohet diskutimi për Teatrin.

Nevzat Isufi: përshëndetje! Në radhë të parë kam vërejtje sepse seanca ka filluar 20 minuta me vonesë, po ashtu mënyra e votimit elektronik e cila është paguar me një shumë të majme, nuk përfillet fare, prandaj, është mirë që të kthehet kjo teknikë pasi që nuk është e nevojshme. Sa i përket rendit të punës kam shumë vërejtje dhe unë e shprehë shqetësimin tim, sepse në mbledhjen e KPF-së ka pasur parregullsi të mëdha, ku nuk është hera e parë që nuk dërgohet materiali me kohë, e në veçanti kësaj radhe gjysma e pikave të rendit të punës së Kuvendit janë futur pa shqyrtim në KPF dhe Rekomandim në Kuvend.

Nga pika 2.6 deri te pika 2.10, janë pika që falë kryesueses dhe kolegëve të mi të KPF-së, janë kontrabanduar në rendin e punës të ditës së sotme të seancës së Kuvendit. E di që dikujt mund t'i duket i rëndë ky fakt, por unë mendoj se është kështu, sepse të gjithë e dimë që në tavolinat e tona nuk kemi pasur asnjë shkronjë të vetme dhe asnjë material për këto pika që i përmenda. Të gjitha këto pika që lidhen me subvencione janë rekomanduar me sy mbyllur në Kuvend, prandaj janë shkelur të gjitha procedurat dhe Udhëzimi Administrativ për transparencë. Kjo për mua është skandaloze sepse është bërë shkelje drastike e ligjit.

Përgjegjësit, nuk i kanë kryer detyrat me përgjegjësi, prandaj kjo ka bërë një varg shkeljesh të mëdha. Këso parregullsi po ndodhin edhe në komitetet tjera, ku caktohen pikat e rendit të ditës pa pasur material fare, madje edhe kur ka material ato dërgohen me vonesë. Kjo është bërë e ditur nga anëtarët e komiteve që e përfaqësojnë subjektin tonë politik. Kjo praktik duhet të ndalohej njëherë e përgjithmonë, e aq më pak kur bëhet fjalë për ndarjen e subvencioneve të klubeve sportive dhe organizatave të tjera. Nuk besoj që ato klube e organizata do të ndiheshin mirë për ndarjen e subvencioneve duke e ditur që janë shkelur procedura të shumta, sado që këto subvencione janë shumë të nevojshme për to.

Për të qenë paradoks edhe më i madh, ne si grup i anëtarëve të Kuvendit kemi dërguar me shkrim një shkresë (në afat ligjor) për të cilën kemi kërkuar që të futen disa pika të rendit të ditës në KPF, e pastaj të njëjtat të rekomandohen në Kuvend, por kjo nuk është bërë dhe ne injorohemi pa të drejtë, kurse në anën tjetër po futen pika pa material dhe në qasjen e mbajtjes së mbledhjes ne i mbylлим sytë dhe themi se gjithçka është në rregull. E njëjta logjikë, apo më mirë të themi alogjikë, po ndodhë te pyetjet apo kërkesat e ndryshme që parashtrihen, e për të cilat nuk marrim përgjigjeje fare, e ato janë diku rreth 80 % të pyetjeve. Mjafton vetëm të shfletoni procesverbalin të cilin e keni para vetes të mbledhjes së kaluar dhe do të bindeni për këtë. Prandaj, këto vërejtje që i dhashë duhet të ushtrojnë presionin e vetë, edhe pse nuk e kemi të pranishëm Kryetarin e Komunës i cili do të ishte përgjegjës, sidomos në mosdhënien e përgjigjeve nga drejtoritë e caktuara.

Valentina Bunjaku- Rexhepi: lidhur me vërejtjet e z. Isufi, keni të drejtë plotësisht, por në mbledhjen e KPF-së unë kam kërkuar mirëkuptimin tuaj që pikat e rendit të ditës që kanë të bëjnë me subvencione të futen aty për aty, duke e ditur nevojën e klubeve, sepse më vonë do të ishte e kotë. Kërkoj falje për neglizhencën që është bërë, por nuk do të lejoj që herëve të tjera të kemi këso parregullsi dhe të futen pikat e rendit të ditës pa material apo aty për aty.

Sa i përket kërkesave tuaja, ne kemi ende kohë për të kthyer përgjigjeje sepse kemi afatin 30 ditë dhe tani sekretaria do të siguroj pyetjet që i keni adresuar dhe do të mundohemi që në vazhdim të japim përgjigje dhe nëse ndonjëra është e arsyeshme që të futet si pikë e rendit të ditës në Kuvend, atëherë patjetër që do e fusim.

z.Abazi kërkoi që të diskutohet edhe Teatri, por unë ju kisha kërkuar mirëkuptim që në këtë seancë të mos diskutohet, sepse nuk e kemi në rend të ditës, por në seancën e radhës do ta keni pikë të veçantë.

Bujar Nevzadi: përshëndetje! Unë kam qenë njëri nga anëtarët që në mbledhjen e KPF-së i kam votuar pikat që kanë të bëjnë me subvencione edhe pse këto propozime kanë qenë pa material. Në mbledhjen e KPF-së unë kam diskutuar për klubin Futbollistik "Drita" (F), kurse në material ka ardhur klubi Volejbollistik "Drita" (F). Unë nuk kam asgjë kundër klubit volejbollistik "Drita" (F), por kam kërkuar që në subvencione të futet klubi Futbollistik "Drita" (F), dhe kjo është gabim që është futur kështu. Ne si grup nuk pajtohemi që mos të diskutohet sot çështja e Teatrit, sepse në KPF kemi diskutuar dhe kemi votuar për këtë pikë që të jetë sot në rend të punës. Kam kërkuar raport analitik për manifestimin mbarëkombëtarë "Flaka e Janarit 2016", dhe një raport të tillë nuk e kemi fare, nuk kam pasur vërejtje te shuma e të hollave, por kam dashur ta kem një raport se kujt ju kanë dhënë atë të holla. Prandaj mosardhja e raportit na fut në dyshim se në këtë manifestim ka pasur keqpërdorime në shpenzime. Edhe në KPF, por edhe sot po kërkoj në përgjigjeje, për zgjedhjen e drejtorëve të Shkollave të Mesme ? Të gjithë e dimë që dy herë janë shpallur dhe janë mbyllur konkurset për këtë çështje.

Sahit Abazi: të them të drejtën unë mendova se çështja e Teatrit e cila nuk është sot si pikë e rendit të ditës, ka ndodhur për shkak të ndonjë gabimi teknik, por këmbëngulësia e juaj më bënë të dyshoj se është e qëllimshme mos futja e Teatrit dhe raportin analitik si pikë e rendit të ditës. Kjo na tregon se nuk ka seriozitet në punën e juaj si pushtet, ose nuk keni dëgjuar fare se çka është diskutuar në mbledhjen e KPF-së, ose nuk ju ka konvencuar që të jetë pjesë e diskutimit çështja e Teatrit.

Mendoj se nuk ka qenë gabim teknik, sepse në momentin që po e mohoni atë që ka ndodhur realisht, atëherë i bie se ky është qëllim i juaji. E para, të themi se në Teatër Komuna e Gjilanit ka shpallur një konkurs, zyrtarët e Komunës thonë që ky konkurs është për t'i legalizuar punëtorët e Teatrit, atëherë nëse legalizohen, kjo i bie se këta punëtorë kanë qenë ilegal deri tani. E dyta, ky nuk është një konkurs për punë, por një konkurs për shërbime, për shkak se Komuna në këto rrethana nuk mundet të punësojë aktorë, prandaj kjo duhet t'u sqarohet aktorëve.

Megjithatë, kjo duhet të jetë pjesë e diskutimit të hapur edhe pse nuk e kemi as Kryetarin e Komunës për të pasur diskutim, por për ne është e rëndësishme që të jepen sqarime, e për çështje të tjera mund të diskutojmë në seanca tjera, por tani nuk është e drejtë të mos lejohet diçka që e kemi votuar. Ky ka qenë konsensus i përbashkët, po ashtu edhe kolegu nga Vetëvendosja, këtë qëndrim që e mbajti sot, e ka mbajtur edhe atë ditë, përndryshe duhej të bëhej një lëshim i lehtë për shkak se klubet sportive kanë nevoja të mëdha, duke e dikur se ky është defekt i kësaj qeverisjeje, për shkak se nuk ka seriozitet në punë, sepse sikur të kishte seriozitet, asnjë prej rregullave nuk do të shkelej, por pikat e rendit të ditës do të vinin ashtu siç duhej, e ne nuk do e kishim shkelur as Ligjin e as Rregulloren, por për mos me i lënë klubet sportive keq, ne kemi ardhur në këtë gjendje dhe po duhet të i shkelim edhe Ligjet edhe Rregulloret.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: faleminderit z. Abazi, por meqë sot shumë po insistoni ju them se nuk është neglizhencë e askujt, por është për shkak të mos përmbylljes së subvencioneve nga ana e klubeve.

Abdyl Aliu: tani duke i dëgjuar kolegët e mi, sidomos z. Abazi dhe z.Nevzadi, atëherë po pyes a mos ka mbajtur KPF-ja ndonjë mbledhje përveç asaj të datës 22.03.2016 ? Nëse është fjala për mbledhjen e kësaj date nuk kemi votuar që Teatri të jetë si pikë e rendit të ditës për seancën e sotme të Kuvendit. Është e vërtetë që atë ditë në mbledhjen e KPF-së kemi biseduar për Teatrin dhe për këshillat e fshatrave, por kemi thënë që duhet të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë për këto çështje, por nuk kemi thënë që në këtë seancë të diskutohet për to. Edhe sot qëndroj pas asaj që kemi diskutuar atë ditë, që këto dy pika të futen në rend të ditës në ndonjërin nga seancat e Kuvendit.

Lidhur me rendit e punës, grupi i këshilltarëve të LDK-së është për të vazhduar me këtë rend të punës, por me një ndryshim të vogël ku propozojmë që pikat 2.6 deri 2.10 që kanë të bëjnë me subvencionet të futen në një pikë të vetme.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: prezent në seancë kemi edhe Koordinatorin për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Bashkim Negjipi dhe shefin e sektorit për sport z.Malazog Hoxha, prandaj kur të vijmë te pikat e subvencioneve të klubeve, gjithçka që ju intereson keni kujt t'i drejtoheni dhe të merrni përgjigje.

Pajtohem me z. Aliu, që në mbledhjen e KPF-së ne kemi diskutuar për Teatrin, por nuk kemi votuar dhe nuk kemi marrë vendim që në këtë seancë të jetë si pikë e rendit të ditës. Kjo puna e Teatrit z. Abazi ty të është përvetësuar, sepse po bënë shumë zhurmë që disa herë, thua që vetëm ju po e doni Teatrin.

Fehmi Sylejmani: edhe unë mendoj që rreth pikave të rendit të ditës, kjo seancë të ndahet në katër pjesë. E para pjesë të jetë çështja e Raportit Financiar, e dyta le të jetë Informata e manifestimit “Flaka e Janarit”, pjesa e tretë le të hyjnë pikat e subvencioneve, kurse pikat e subvencionimit të OJQ-ve të jenë në pjesën e katër. Nuk është se po e mbroj shefin tim, por ka pasur plotësisht të drejtë që nuk ka lejuar të shkelet Ligji dhe unë prapë mendoj që faji kryesor është i klubeve që kanë aplikuar për subvencione me vonesë. Mendoj se më vonë do të flasim se aty ka edhe keqpërdorime për të cilat do të bindeni edhe vetë. E përmendët ju zonja Kryesuese se përgjigjet po i ktheni, por unë po ta bëj me dije se në korrik të vitit 2015 kam dërguar pyetje dhe nuk kam marrë përgjigje. Zyrtarët e juaj përkatësisht disa drejtor më

kanë thirrur në telefon dhe më kanë thënë se ju kemi dhënë përgjigje, por unë nuk kam marrë. Tash kam filluar të aplikoj për çdo kërkesë dhe për gjithçka, do ta shihni se është e vërtetë. Ne i kemi adresuar shumë pyetje, por pak kemi marrë përgjigje. Ne kemi kërkuar nga Drejtoria e Arsimit një informatë se pse po anulohen dhe po zvarriten konkurset për drejtorë dhe për zyrtarë. Po ashtu e kam një kërkesë të veçantë çfarë përgjigje ka marrë Komuna nga MAPL, për ligjshmërinë e projektit të Lumit “Mirusha”?

Valentina Bunjaku-Rexhepi: ne kemi kohë për të kthyer përgjigje, ka mundur teknikisht të mos punoj kompjuteri juaj, por ndërkohë besoj që përgjigjet do të kthehen.

Sahit Abazi: edhe në fjalimin e z. Aliu e kuptuam se në seancën e KPF-së, ka pasur diskutim rreth Teatrit dhe “Flakës së Janarit”, por këtë punë mund ta vërtetoni me procesverbal. Nëse e keni procesverbalin e gatshëm, mund ta kuptoni se pak minuta para se të hedhet në votim nga ana juaj, ne ju kemi pyetur se a janë në votim edhe dy propozimet e tona dhe ju e keni pohuar. Sa i përket përvetësimit të Teatrit dhe asaj që unë e dua Teatrin, atëherë mos vet për ata që nuk e duan Teatrin.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: nuk po kthehemi në procesverbal, sepse është jo njerëzore të obligohet sekretaria të nxjerrë procesverbalin tani, por propozimin e juaj po e hedhim në votim dhe vazhdojmë tutje. Propozimin e juaj e kemi diskutuar, por nuk e kemi votuar në mbledhjen e KPF-së. Ne kemi thënë se keni të drejtë për këtë gjë, por kemi thënë që në njërën nga seancat e ardhshme do ta diskutojmë çështjen e Teatrit. Koha për diskutim rreth pikave të rendit të ditës ka kaluar dhe mendoj se nuk kemi më se çfarë të diskutojmë.

Bujar Nevzadi: mos e keqpërdor pozitën e Kryesueses sepse këtu jemi të gjithë anëtarët e KPF-së, dhe është e vërtetë që ne e kemi votuar propozimin tonë, është shumë e vërtetë që kjo gjë ka ndodhur, z. Abazi ju ka pyetur se a do të hynë në rend të ditës së seancës së Kuvendit edhe dy propozimet tona dhe ju e keni pohuar, prandaj ne e kemi votuar. Komiteti ka vendosur që në rend të ditës së Kuvendit të jetë edhe çështja e Teatrit dhe kjo që po e them është shumë e vërtetë.

Nevzat Rushiti: unë vetëm desha të arsyetoj, pasi që jam anëtar i KPF-së, është rregull që çdo propozim të votohet, prandaj mos të keqkuptohemi sepse në mbledhjen e KPF-së, ne kemi thënë që çështja e Teatrit në të ardhmen të diskutohet, kurse votim nuk kemi bërë. Po ashtu Kuvendi nuk ka të bëjë me konkurse, po ashtu edhe për këshillat e fshatrave kemi thënë se është mirë të diskutohet për të ardhmen, prandaj unë mendoj që të kalojmë në pikat e rendit të ditës të cilat i kemi tani.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: unë nuk po e keqpërdorë pozitën e kryesueses, por kërkoj që të gjejmë një mirëkuptim dhe këto propozimet e juaja të i hedhim në votim, e nëse ju nuk dëshironi që këto propozime të dalin në votim, atëherë mbaroi debati rreth pikave të rendit të ditës. Mund ta merrni fjalën z. Abazi për replikë edhe pse qe pesë herë diskuton për të njëjtën çështje.

Sahit Abazi: kërkoj nga kolegu z. Nevzat Rushiti që mos t’i merr këto punë hajgare, sepse sinqerisht ne këtu nuk jemi hajgarëxhinjë. Nuk mund të thuhet se kjo është ide e mirë, e ne kemi thënë sa ide e mirë, sepse dy të vërteta nuk mund të jenë kurrë me një vend, kurse dy e ma tepër mashtrime mund të jenë me një vend. Ka pasur incizime dhe procesverbal për ta vërtetuar atë që ne e themi, prandaj ne nuk vijmë këtu të themi se është ide e mirë apo po shkëlqejmë këtu, por qëllimi është të respektojmë rregullat, prandaj kërkoj nga kolegu z. Rushiti që këto punë mos t’i shndërroj në cirk, sepse ky cirk mund të përcillet edhe dika tjetër dhe sinqerisht dua që të ruhet raporti kolegjial.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: nuk mund ta jap fjalën z. Rushiti. Ata që e përmendin cirkun, po e përdorin vetë këtë gjë. Ne nuk jemi këtu për cirke, por jemi për punë konkrete, atëherë ju lutem të na lejoni të punojmë. Diskutimi rreth pikave të rendit të ditës mbaroi dhe unë këtë rend të ditës po e hedhë në

votim me ndryshim që pikat që kanë të bëjnë me subvencione (2.6 deri 2.10) të hynë në një pikë të vetme.

Aprovohet rendi i ditës me 16 vota “për”, 9 vota “kundër” të tjerët “Abstënime”

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2.1. Raporti Financiar janar-dhjetor 2015

Zijadin Maliqi: përshëndetje për të gjithë! Do të mundohem që në vija të trasha të paraqes Raportin Financiar përfundimtarë për vitin 2015, pasi mendoj se në mënyrë detale i keni marrë diku 33 faqe raport, duke përfshirë prej buxhetit të planifikuar fillestarë e deri te ai përfundimtarë, pastaj të gjitha të hyrat, shpenzimet në kategori e deri te borxhet e mbetura të cilat janë bartur në vitin 2016.

Buxheti i planifikuar për vitin 2015 ka qenë 21.839.768,00 €, pastaj këtij buxheti ju kanë shtuar edhe mjetet e bartura nga donatorët që janë bërë me vendim të Kuvendit dhe kjo shumë ka arritur në 23.194.382,31 €. Buxheti i shpenzuar nga ai që përfundimisht është planifikuar, arrin shumën prej 21.768.303,44 €, apo 94 % .

Buxheti i pashpenzuar ka qenë 1.426.078,87 €, nga Grandi Qeveritarë janë 11.482,03 €, participim në projekte kapitale nga qytetarët dhe donacione nga Organizatat e ndryshme janë 177.788,35 €, të hyra vetanake që barten në vitin 2016 janë 1.004.614,67 €, mosrealizimi i planifikimit të hyrave vetanake për vitin 2015 është 232.193,82 €.

Në realizimin e të hyrave vetanake ka ndikuar kategoria e Tatimit në Pronë, ku kemi mungesë 10 %, e cila ka ndikuar pas Ligjit mbi faljen e borxheve, i cili ka hyrë në fuqi me 2 shtator 2015, kurse Departamenti i tatimit, në program ka startuar diku nga gjysma e nëntorit, prandaj dy muaj e gjysme ka pasur inkasim shumë të vogël duke pritur programin që të aplikohet ky ligj. Këtë vit kemi të hyra më të mira për dallim nga viti i kaluar, por kjo nuk ka ndodhur vetëm tek ne por te të gjitha Komunitet e Kosovës.

Në obligimet e bartura në vitin 2016, sipas evidencës që udhëhiqet janë 1.898.273,89 €. Borxhet kryesisht barten te investimet kapitale dhe te shpronësimet. Jam i gatshëm për pyetjet e juaja dhe unë aq sa mundem do të përgjigjem e për ato që nuk mundem do të ju kthej përgjigjeje me shkrim, sepse sistemi i kontabilitetit i ka diku rreth 391 faqe dhe është e pamundur të gjitha të mbahen në mend .

Abdyl Aliu: më lejoni t’i shprehë mirënjohje drejtorit dhe bashkëpunëtorit të tij në punën që e kanë bërë në hartimin e Raportit Financiar janar-dhjetor 2015. Besoj se po ta lexoni raportin me kujdes shihet se kemi të bëjmë me një raport të përgatitur mirë në dy aspektet, si atë përmbajtjesorë ashtu edhe në atë teknik. Drejtori dhe bashkëpunëtorët në këtë raport kanë paraqitur aftësitë dhe aktivitetet reale të punës së realizuar për periudhën kohore një vjeçare nga aspekti financiar. Është raporti i dytë në këtë mandat i drejtorit, por ka kohë që ky drejtor përpilon raporte të tilla. Kjo drejtori sigurisht do t’i përgjigjet interesimeve të juaja në Kuvend. Realizimi i të hyrave është diku rreth 94 % dhe jemi ndër Komunitet që qëndrojmë më së miri në realizimin e planifikimit. Në emër të grupit të këshilltarëve ne e përkrahim këtë raport.

Riad Rashiti: më lejoni që në emër të grupit të PDK-së të paraqes vlerësimin tonë për këtë raport financiar janar-dhjetor 2015. Ne e dëgjuam me kujdes prezantimin e drejtorit të DBF-së, edhe pse tha se ky raport është i shkurtër, ne si opozitë kemi shumë vërejtje për mënyrën se si është përpiluar dhe si është paraqitur para neve ky raport.

Në këtë raport mungojnë shumë informacione analitike për të cilat është dashur të jemi të informuar si anëtarë të KK-së. P.sh: nuk është sjellë lista për obligimet e pa paguara, që ta dimë për cilat vite po flasim, për cilat kompani dhe për cilat projekte janë pa paguar obligimet, po ashtu nuk ka informacione për shpenzime apo mos shpenzime për buxhetin e grandeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe pse ne shumë herë kemi kërkuar përgjigje nga kjo qeverisje dhe asnjëherë nuk kemi marrë një përgjigje të tillë. Mungojnë informacionet e detajuara për investimet që janë bërë nga donatorët e ndryshëm për

vitin 2015. Në këtë raport nuk ka asnjë informacion për fondin e ndërtimit të shtëpive në vlerë në 200.000 €. Mosparaqitja e këtij informacioni në këtë raport, ngjallë dyshime serioze se kush po i menaxhon dhe kush po përfiton me këto të holla. Është obligim ta dimë këtë gjë sepse ka qenë organizim nga Kryetari i Komunës në kuadër të Komunës dhe sot nuk figurojnë në buxhetin Komunal këto të holla, atëherë ku kanë mbetur këto para ? Këtë përgjigje e kërkojmë nga drejtori i Buxhetit dhe Financave.

Po ashtu nuk ka asnjë informacion se pse janë rritur shpenzimet në shumë projekte në kategori të ndryshme, si në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, transportin e nxënësve edhe pse kemi bërë pyetje shumë herë, por përgjigje nuk kemi marrë.

Ky raport ka fare pak transparencë për buxhetin dhe mënyrën e shpenzimeve si dhe për buxhetin e pashpenzuar.

U tha më parë se ka pasur të hyrat vetanake, janë të mira, por krahasimi i vitit 2014 me vitin 2015, shihet se viti 2015 është më i dobët dhe tregon se ka rënie të efikasitetit të të hyrave vetanake për 70.000 €.

Te shfrytëzimi i buxhetit Komunal që ka qenë në vitin 2015, nuk është realizuar ashtu siç është miratuar nga Kuvendi Komunal, që do të thotë se KK-ja kot e ka miratuar këtë buxhet që vet e ka propozuar Kryetari i Komunës, por ky kryetar i Komunës ka shpenzuar buxhetin ashtu siç ka dashur sipas dëshirave dhe prioriteteve të cilat nuk kanë qenë të planifikuara, siç është rasti te bursat e studentëve, është miratuar 70.000€ fondi për bursa dhe asnjë euro nuk është dhënë nga ky miratim duke u arsyetuar disa herë se nuk ka mjete financiare, mirëpo në fund të vitit del se janë 1.000.000 € suficit, buxhet i mbetur i Komunës së Gjilanit i pa shpenzuar, që do të thotë se këtu ka parregullsi serioze për mënyrën se si është shpenzuar buxheti nga planifikimi të hyrave të buxhetit.

U përmendën shifra nga drejtori i Buxhetit se sa ka qenë planifikimi i buxhetit për vitin 2015 në 23.194.000,00 € ndërsa janë shpenzuar 21.768.303,44€, që nënkupton se pjesa e mbetur nuk janë shpenzuar fare nga ky buxhet dhe kjo do të thotë se kemi të bëjmë me një paafësi, keqqeverisje dhe keq menaxhim i buxhetit nga tërë ekzekutivi i Komunës së Gjilanit. Vet fakti që Komunës i kanë mbetur 1.000.000,00€ suficit, do të thotë se Komunës i kanë tepruar borxhet, kurse tërë vitin është ankuar se ka trashëguar borxhe të qeverisë së kaluar, mirëpo në fund të vitit del se Komunës së Gjilanit i kanë mbetur para kesh mbi 1.000.000,00 € vetëm nga të hyrat vetanake. Edhe te kategoria e subvencioneve Komunës i ka tepruar buxheti dhe shtrohet pyetja pse ? kur dihet se kërkesat kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha nga institucionet e ndryshme e siç është Teatri dhe Komuna ankohet se nuk ka buxhet. Nga mbetja e këtyre subvencioneve të pa shfrytëzuara kanë pësuar edhe OJQ-të, siç janë Hendikosi, Shoqata e të Verbërve, Shurdhmemecët, ku në bazë të raportit shihet se Organizatës së Shurdhmemecëve gjatë vitit 2015 i është dhënë një përkrahje me të holla në shumë 350 € dhe kjo është absurde, sepse këto 350€ ju i keni shpenzuar brenda ditës në pije dhe ushqim.

Duhet të jap sqarim para qytetarëve të Gjilanit, se nuk kanë vetëm 1.000.000,00€ që kanë tepruar Komunës së Gjilanit suficit, sepse këto janë vetëm nga të hyrat vetanake, por janë 200.000,00€ të pashpenzuara për të cilat nuk dimë se kush po i menaxhon dhe në llogari të kujt janë, andaj është mirë që ju zonja Kryesuese të na informoni se këto të holla pse nuk janë në llogari të Komunës por janë në llogari private për të cilat ne nuk e dimë se te kush janë. Po ashtu kemi suficit nga Grandet e Qeveris së Republikës së Kosovës mbi 700.000,00€.

Komuna e Gjilanit gjithmonë është arsyetuar me mungesë të buxhetit dhe me mbështetje të vogël financiare nga Qeveria e Kosovës dhe ka deklaruar se shumë projekte nuk po mund të realizohen për shkak të kësaj mungese, siç është projekti i Lumit “Mirusha” i cili ka mbetur ashtu siç e kemi lënë ne si PDK në vitin 2013. Ai projekt ka dështuar, tani më ka mbetur historik dhe është mirë të propozohet se besojmë që i plotëson kushtet të hy në libër të “Genisit” për kohën e zgjatjes së sajë.

Nëse shohim shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë harxhuar mbi 50.000 €, që janë shpenzuar për bileta, hotele e lukse si dhe shëtitje nga Kryetari i Komunës dhe zyrtarët e tjerë Komunal. Prandaj kjo nuk del siç ka thënë Kryetari në deklaratën e dhënë publikisht se këto shpenzime nuk janë të vërteta duke i mohuar kategorikisht, derisa ne i kemi para vete raportet e marra nga DBF, ku shihet se Kryetari i Komunës ka shpenzuar 7094 € vetëm për bileta, 4236€ për mëditje, 6147€ ekstra shpenzime për hotele

dhe pa dashur të hy edhe te shpenzimet e telefonit për të cilat i keni parë edhe vetë që kryetari i Komunës nuk ka vetëm 20 € shpenzime mujore të telefonit.

Selami Xhemajli: në emër të grupit po i jap vlerësimet tona për këtë raport. Ky raport është i hartuar mirë dhe ka të gjitha të dhënat për drejtori e njësi dhe zyre. Falënderoj drejtorin e DBF që gjithmonë jep përgjigje kredibile dhe korrekte. Vet fakti që planifikimi i buxhetit ka 94 % të realizimit, tregon se kemi një performancë të mirë me menaxhimin e buxhetit.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: është mirë që në Kuvendin Komunal së pari të përfundohet diskutimi e pastaj të botohet si lajm, sepse z.Riad Rashiti ende pa e kryer diskutimin, Gazeta Rajoni Pres e botoi fjalimin e tij, sepse ju ende pa i përmendur fondet për ndërtimin e shtëpive, Rajoni Pres e botoi komplet diskutimin tuaj, prandaj nuk është mirë të keqpërdoren mediat.

Riad Rashiti: zonja Kryesuese, së pari nuk po të kuptoj se çfarë dëshiron të thuash, unë nuk jam përfaqësues i mediave, nuk jam pronar apo përgjegjës i gazetës Rajonipres, ju gabim e keni adresuar pyetjen, prandaj kujdes sepse nervoza e juaj po tregon se diçka ka këtu për të dyshuar. Për dilemat që ne i themi në seanca, ju nervozoheni, prandaj kur ka nervozë ka diçka të fshehur. Ju e keni për detyrë të udhëhiqni seancën e Kuvendit, gazetarët kanë punën e tyre, e ne si opozitë punët tona, prandaj mos ndërhy në punët e huaja.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: unë vetëm dua ta sqaroj opinionin se 10 minuta pa folur ende ju z.Rashiti, kjo gazetë publikon diskutimin tuaj, prandaj nuk mund ta din gazeta se çfarë do të diskutosh t'i nëse nuk ke folur ende.

Krenare-Latifi-Kqiku: siç po shihet në këtë raport po del se kemi një qeverisje jo efikase, në realizimin e objektivave të parapara sipas buxhetit të planifikuar dhe po konstatohet se Kryetari dhe drejtorët e drejtorive përkatëse, nuk po qeverisin në mënyrën e duhur. Andaj, edhe një herë si opozitë ju kujtojmë se e keni mandatin dhe obligimin qytetarë për të qeverisur mirë. Ne si grup opozitar jemi kundër këtij raporti financiar. Nga ky material i ofruar i këtij raporti, ne jemi të pakënaqur dhe do t'i japim vërejtjet tona duke u bazuar në shënimet dhe argumentet e juaja në këtë raport. Buxheti fillestar i planifikuar për vitin 2015 është 21.839.768,00€, ndërsa planifikimi përfundimtar me të gjitha grandet, mjetet vetanake dhe mjetet e bartura suficit nga viti i kaluar, kapin shumën rreth 23.194.382,31 €. Këtu vërehet një diferencë e madhe në mes të planifikimit fillestar dhe atij përfundimtar. Ky raport financiar bie në kundërshtim me shifrat e deklaruara, nga faqja e parë e raportit ku thuhet se buxheti i planifikuar nuk është shpenzuar për shumën 1.426.778,00 €, nga burimet e financuara si grandit i përgjithshëm, participimi me projektet kapitale dhe të hyrat vetanake prej 1.004.614,67 € që kjo shumë është bartur në vitin 2016.

Në faqen 33 të këtij raporti thuhet se kemi obligime njëkohësisht të pa paguara prej 1.898.237,00 €, ku këtu kërkoj nga drejtori i DBF të na jam sqarime.

Në vazhdimësi kemi dhënë vërejtjet tona në raporte të tilla, siç është raporti financiar janar-shtator 2015, ku është fjala për të hyrat vetanake, ku kemi pasur një mos inkasim të këtyre mjeteve në krahasim me planifikimin e asaj periudhe. Në faqen 5 të këtij raporti, te të hyrat vetanake është planifikuar 3.859.953,00 €, kurse është realizuar 3.627.759,18 € dhe në këtë pikë dua të ndalem te të hyrat e disa sektorëve, p.sh te DAP janë planifikuar 170.000 €, kurse janë realizuar vetëm 127.554 €. Të hyrat nga biznesi kanë qenë të planifikuara 150.000 €, kurse janë realizuar 91.573 €. Të hyrat nga inspeksioni janë planifikuar 45.000 €, kurse janë realizuar 3.060 €.

Qeverisja e juaj deklaroi se ka realizuar planin, kurse në praktik del e kundërta. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve kanë një kosto të lartë në të gjithë sektorët. Shpenzimet e Kryetarit janë 28.172 € për vizita jashtë vendit, por Kryetari asnjëherë nuk ka raportuar për këto vizita. Po ashtu edhe DSHIP ka shpenzuar 148.635 €, ku thuhet se ka kontrata në vepër, mirëmbajtja dimërore, shërbimet e varrimit, ku për të njëjtin kod edhe zyra e Kryetarit ka shpenzuar 28.636€.

Po ashtu kodi 14230 të shërbimet për informim publik nga zyra e Kryetarit janë 11.766 €. Sa i përket drekave zyrtare kemi një rritje nga viti në vit.

Desha ta pyes edhe Kryetarin se ku do të investohen këto mjete dhe në bazë të cilave vija buxhetore do të shpenzohen këto mjete, se në deklaratat e fundit ke thënë se pritet të investohen rreth 3.5 milion € në rrugët e fshatrave dhe të qytetit, për cilat projekte e keni fjalën konkretisht ? Kryetari e ka bërë praktikë që para seancave të mbaj një konferencë me gazetarë apo paraqitje mediatike dhe takime me bordin, sa për t'i bindur qytetarët që po punojnë.

Po ashtu kërkoj një informatë për rrugën e fshatit Pogragjë, ku gjatë fushatës kanë premtuar se ajo rrugë do të asfaltohet dhe u bënë më shumë se 2 vite qeverisje dhe asgjë nuk është intervenuar dhe ajo rrugë tërësisht është e degraduar dhe mirëmbajtjen mundohen ta bëjnë vet banorët e fshatit, sa mjete janë planifikuar për atë rrugë dhe kur pritet të filloj puna ? Po ashtu kur do të filloj puna për lumin “Stanishorka” ? sepse keni deklaruar se e keni në plan të punës rregullimin e shtatit të lumit. Po ashtu dua një arsyetim sepse rreth 400.000 € janë shpenzuar për rrugët e rendit të tretë.

Valentina Bunjaku Rexhepi: pyetjet e juaja znj.Latifi që i keni për drejtorin tani do ta merrni përgjigjen, kurse pyetjet për Kryetarin, përgjigjet do t'i merrni me shkrim.

Nevzat Isufi: kemi vërejtje rreth raportit, sepse ne kemi thënë që këto forma të raportit duhet të ndryshohen, të rifreskohen pak, sepse tani të gjithë e dimë se nuk ka më drejtori të Inspeksionit. Edhe te shuma e shpenzimeve unë kisha thënë se shumë shpenzime janë bërë kot, sepse nga kjo Njësi nuk ka gjopa, nuk ka të hyra dhe mungon puna e tërësishme. Të korrigjohen këto gabime sepse kjo tregon se është punuar vetëm shabllon ky raport.

Shukrije Rapuca: te drejtorja e Bujqësisë është një diskrepancë e madhe në mes planifikimit dhe realizimit të mjeteve.

Drejtorja për Bujqësi për vitin 2015 ka planifikuar 290.000€, kurse ka realizuar vetëm 143.000€ dhe kjo do të thotë se as gjysma nuk janë realizuar. Kjo drejtori nuk i ka përmbushur obligimet për investimet kapitale, për këtë vijë buxhetore kanë qenë të planifikuara 180.150 € kurse janë realizuar vetëm 92.204 . Të gjithë e dimë se kjo drejtori më së lehti krijon vende të reja të punës, por me këtë ecje të kësaj drejtorie shihet se është e vështirë të plotësohet kërkesa e shumë njerëzve.

Ismet Hajdini: i dëgjova me vëmendje reagimet e opozitës, por me të vërtetë me habitë fakti se të gjitha këto kritika të bëjnë të mendosh se ky plan paska dështuar 94%. Asnjë fjalë nuk është përmendur për rritjen e të hyrave, p.sh te lejet e ndërtimit, shërbimet publike, gjeodezia, të hyrat në bujqësi. Sipas opozitës gjithçka është zi.

Krenare Latifi-Kqiku: nuk kam thënë se 93% nuk është realizuar, por kam thënë se 93% ka qenë e realizuar. Ne nuk shohim vetëm zi, por puna e jonë është t'i shohim gabimet e juaja, kurse punët e bardha shpaloseni ju vetë, kështu që unë ju kam referuar vetëm këtij raporti financiar.

Isa Agushi: nuk është lehtë me arrit në pushtet, sepse duhet të punohet shumë. PDK-ja është dënuar nga qytetarët sepse nuk ka punuar, por nëse as ne nuk punojmë edhe ne mund të dënohemi nga qytetarët. E përgëzoj drejtorin për raportin e bërë, si dhe 94% e realizimit të planifikimit është një punë shumë e madhe e kryer. E dëgjova parafolësin tim duke thënë se janë shpenzuar 50.000 e për vizita jashtë vendit, por unë nuk e besoj që kjo është e vërtetë. Nëse ju po thirrreni në parregullsi dhe keq menaxhim të buxhetit, atëherë pse nuk i denonconi rastin në polici. Nëse ju më bindni që ka keq menaxhim me argumente atëherë unë do të vijë me juve ta denoncojmë rastin së bashku.

Te investimet kapitale për herë të parë në historinë e Komunës së Gjilanit janë 25.000.000,00€.

Lumi “Mirusha” parafolësi im tha se nuk është rregulluar, por kjo po ndodhë nga viti 2008, por atëherë ne nuk kemi qenë në pushtet, dhe kjo dëshmon që e keni pasur qeverisjen, por nuk e keni përfunduar atë projekt, por besoj që tani ne do ta përfundojmë se nuk do të mbetet ky Lum si “Ura e Shenjët”.

Ramiz Ramadani: me konsideratën maksimale për t'u përgjigjur në pyetjen e znj. Rapuca, mendoj që se paku në pikën e buxhetit do të ishte dashur të nderohen vetëm shifrat, sepse nuk duhet të ketë politikë. Vërejtjet janë të adresuara mirë, por mendoj se kemi bërë investime në mënyrën më të mirë të mundshme. Te investimet në drejtorinë e Bujqësisë, është e vërtetë që kanë qenë të planifikuara 290.000 €, dhe 118.000 € te investimet kapitale.

Te investimet kapitale ne kemi realizuar 92.204 € ose 96%, kurse te subvencionet janë 143.000€ të realizuara. Nga mbetjet tona janë paguar pagat e Teatrit. Po ashtu një mbetje tjetër që na ka përcjellë kanë qenë se gjatë gjithë vitit i kemi pasur të planifikuara edhe dy projekte të cilat për fat të keq nuk kemi mund t'i realizojmë: “projekti i mjedrës” dhe “projekti me partneritetin Austriak”.

Janë edhe 125.625 € nga donacionet në bujqësi të cilat nuk po figurojnë këtu. Por në drejtorinë tonë ky investim është më i madh që ndonjëherë ka ndodhur dhe ky investim është njëri ndër investimet më korrekte.

Bujar Nevzadi: kam disa reagime sepse me detyruan kolegët t'i bëj, por sigurisht duhet të ju informoj kolegu i zyrës për informim se seanca e Kuvendit jepet drejtpërdrejtë në televizion dhe në dy radio.

Gazetari i 2Lonline ka shkruar tri shkrime drejtpërdrejt nga këtu, kurse një tjetër më shkroi dhe më tha tregoi Kryesueses se jam duke e dëgjuar drejtpërdrejtë në radio Energji.

Mendoj se kolegu z.Agushi ka bërë shaka, kur tha që tregojeni një projekt të cilin e keni përfunduar sa kemi qenë ne në pushte, por ai e din mirë se shkolla në fshatin Zhegër është realizuar me të holla milionëshe. Kur unë kam qenë drejtori i Drejtorisë së Arsimit janë ndërtuar 8 shkolla, mbi 35.000 m² salla edukatës fizike, çerdhe etj. Prandaj, mendova se ke bërë shaka i nderuar koleg.

Kjo qeveri ka bërë shumë ndërtime pa leje, nuk besoj që ka në Kosovë ndërtime më shumë se te ne. Te fondi humanitar, mos transparenca e saj tregon që ju po fshihni diçka.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: zyra informimit, nuk e ka asnjë problem më të vogël me mediat. Nuk kam asgjë personale me mediat, por fjala është se artikulli është botuar para se z. Rashiti të përfundoj diskutimin e tij. Ne kemi dëshmi për këtë, unë jam e hapur për të gjitha mediat.

Zijadin Maliqi: ne kemi thënë se ky është raport financiar për shpenzimet dhe të hyrat brenda vitit 2015.

Nuk ia zë për të madhe dikujt që nuk e kanë profesion këtë punë, por ja zë për të madhe z. Rashiti i cili i din të gjitha gjërat. Sa i përket Inspeksionit, ju e dini se ajo është ndarë në drejtori të tjera.

Te të hyrat ndikimi më i madh ka qenë e Tatimit në Pronë. Aktorëve të Teatrit nuk ju kemi mbetur asnjë cent borxh për vitin 2015. Sa i përket mjeteve të solidaritetit nuk janë 200.000 €, por aq sa jam unë i njoftuar janë 112.000€ dhe për këto mjete është formuar Komisioni dhe këto mjete janë bartur në Bankën Kombëtare Tregtare dhe prej aty në Ministrinë e Financave për solidaritet. Një pjesë e tyre janë shpenzuar për qiraja për familjet pa të ardhura. Për mëditjet jashtë vendit ne ju kemi dhënë shënime zyrtare, kurse z. Rashiti thotë se nuk jeni transparent.

Ne jemi e vetmja Komunë që japim kesi raporti, sepse komunat e tjera i përmbledhin gjërat ne 4-5 faqe.

Riad Rashiti: unë nuk e pranoj atë që e tha drejtori, sepse edhe në seancat e kaluara kur ne diskutojmë, tendencë është të personalizohen gjërat. Sot po diskutojmë për Raportin Financiar 2015, për punët që i ka bërë Komuna e Gjilanit, për projektet që janë realizuar. Më vjen keq që barra kryesore sot i ka rënë drejtorit të DBF, sepse Kryetari i Komunës mungon me një pikë aq të rëndësishme siç është kjo, po ashtu edhe drejtori i Prokurimit mungon, dhe normalisht që drejtori i DBF detyrohet të jep përgjigje duke i personalizuar gjërat. Ne jemi të vetëdijshëm që ju drejtor nuk jeni përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të buxhetit gjatë vitit 2015, ju e bëni punën administrative të të gjitha drejtorive dhe i paraqitni shifrat këtu. Ne nuk ju akuzojmë juve personalisht, dhe nuk qëndron ajo që ju nuk jeni transparent, por fjala është për raportin, sepse fare nuk ka transparenca në të. Përgjegjësit mungojnë, e ju

mundoheni të arsyetoni e të mbuloni atë që e bëjnë komplet kjo qeverisje Komunale, por mos i personalizoni gjërat.

U tha se nuk i dimë grandet e Ministrisë, sa janë paguar ? sa janë ndarë? Një drejtor i DBF-së që nuk e din se sa para ndahen për projekte kapitale, sa janë shpenzuar dhe për cilat projekte janë shpenzuar, atëherë nuk e di se kush mund ta dinë këtë çështje. Askush nuk është në gjendje të tregoj se sa projekte janë realizuar, sa kanë dështuar dhe sa të holla kanë tepruar, këtë gjë dikush duhet ta di, andaj nuk është përgjigje të thoni se nuk dimë sepse dikush duhet ta di.

Keni shpallë tender për ndërtimin e shtëpive, po ashtu z. Arbër Ismajli herë është e herë nuk është shef i Kabinetit të Kryetarit.

Sa i përket fondit humanitar, ne e kemi çmuar këtë aftësi, por këtu ka paqartësi të shumta të cilat nuk duhet lejuar.

Te subvencionet 249.000€ kanë tepruar dhe kjo tregon se ka keq menaxhim të skajshëm të buxhetit të Komunës sepse po ju mbesin miliona euro dhe ju nuk dini se ku t'i shfrytëzoni. Nuk mund të merren paratë e subvencioneve nga Drejtoria e Bujqësisë dhe të ju jepen aktorëve të Gjilanit, sepse ata e kanë të planifikuar buxhetin, por as këtë vit ju nuk keni asgjë për ta. Prandaj mos u mundoni t'i mbuloni dështimet e kësaj qeverisjeje.

Nevzat Isufi: pajtohem me konstatimin e drejtorit të DBP i cili tha se këtu po flasim me shifra, por më vjen çudi, sepse sikur në raportin financiar ashtu edhe në raportin e Kryetarit të Komunës, kemi anëtarë të Kuvendit të cilët nuk e lexojnë materialin dhe paraqiten në rolin e avokatit të Kryetarit apo në këtë rast të drejtorit.

Unë mendoj se më mirë se drejtori që e mbron vetën askush nuk mund t'i dalë në mbrojtje, sepse ky i ka pasur këto shifra në dorë. Prandaj është mirë që të eliminohet kjo praktika e Avokimit.

Abdyl Aliu: nuk po dua ta luaj rolin e avokatit, por në emër të kolegëve dhe për hir të objektivitetit, kërkoj nga drejtori i DBF-së, që të jetë recidiv ndaj dy kolegëve parafolës, sepse u tha se Drejtori nuk po din të jap përgjigje, prandaj nëse ka diçka që drejtori nuk e dinë përgjigjen, gjë që është e mundshme , atëherë të thotë se për këtë rast nuk ka përgjigje sot dhe përgjigjem në seancën e radhës apo ju adresoj përgjigje me shkrim.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: unë besoj që të gjitha përgjigjet i ka dhënë z.Maliqi, e nëse ka diçka shtesë mund ta merr fjalën.

Zijadin Maliqi: unë asgjë nuk kam personalizuar, sepse e gjitha që është thënë ka dalë prej raportit financiar, por unë e di që ky raport është i tëri i Komunës, shpenzimet i bëjnë drejtoritë përkatëse, ndërsa ne e udhëheqim evidencën.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: besoj se u shterën të gjitha diskutimet rreth Raportit Financiar janar-dhjetor 2015, dhe tani do e hedhë në votim.

Me 18 vota “për”, 10 vota “kundër” e të tjerat “abstenime” miratohet Raporti Financiar janar-dhjetor 2015.

Pas kësaj pike të rendit të ditës, Kryesuesja kërkoj që të mbahet pushim 1 orë.

2.2. Rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, 01. nr. 016-122568 e dt. 29.12.2015

Kryesuesja e Kuvendit hapë diskutimin rreth kësaj pike.

Abdyl Aliu: e dimë që Rregulloren e tillë ne e kemi miratuar me 29 dhjetor 2015 me qëllim që të jetë e gatshme për vitin 2016 dhe këtë jemi duke e aplikuar, por nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregullore ka ardhur për arsye se tani i kemi përfunduar tri projekte apo asete të reja e të cilat janë: Stadiumi ndihmës i qytetit, fushën sportive në Dardani dhe shtëpia e rinisë në Gjiilan.

Kjo Rregullore ka dalë në dëgjim publik, po ashtu ka kaluar edhe në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport, pastaj në KPF dhe tani do të shqyrtohet edhe në Kuvend. Në Rregullore janë paraparë tarifat dhe kjo ka qëllim që këto hapësira të mirëmbahen. Ne si grup i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë Rregullore.

Fehmi Sylejmani: Ne e kemi shikuar këtë Rregullore dhe këto tarifa, por e para punë që duhet të bëjë ky sektorë është përpilimi i një Rregulloreje për punën, mbarëvajtjen dhe shfrytëzimin e sajë. Me 14 mars 2016 në ora 14:00, është mbajtur dëgjimi publik me sportist apo edhe me grupet e tjera të interesit, por këtu nuk figuron se cilat janë vërejtjet apo propozimet e tyre, po ashtu nuk figuron se kush ka marrë pjesë në këtë dëgjim dhe a janë njoftuar të gjithë e sidomos shkollat e futbollit për këtë dëgjim publik. Në përrurimin e kësaj fushe që është bërë nuk janë ftuar futbollistët më eminent që ka qyteti i Gjiilanit dhe mendoj se është bërë një panderë për ta.

Sa i përket tarifave mendoj se paraprakisht duhet të ketë tarifa alternative mujore. Ne mendojmë se për stërvitje të shkollave të futbollit që është e planifikuar mbi 10 € për 1:50 min mendoj se është shifër e lartë, duke konsideruar se një numër i madh i këtyre shkollave nuk kanë nxënës aq shumë. Kur është në pyetje partneriteti i të rinjve, Komuna duhet të jetë shumë tolerante dhe zemërgjerë. Ne jemi të vetëdijshëm se kjo fushë nuk mirëmbahet nëse nuk participojmë, po ashtu jam i vetëdijshëm se në këtë fushë pjesa më e madhe është bërë nga investimet e Komisionit Evropian e jo nga Komuna, prandaj qëllimi ynë është t'i ndihmojmë të rinjtë.

Po ashtu ka vërejtje se për një lojë të futbollit, për tri grup moshat është 50 € dhe unë mendoj se kjo shumë duhet të zbritet në 30 € ose 40 €, ndërsa te tarifa e parë maksimumi të jetë 20 €.

Te pika 8.3 që ka të bëjë me shfrytëzimin e stazës së atletikës mujorja prej 5 €, mendoj se është e arsyeshme, por sugjeroj përgjegjësit e asaj fushe që aty mos të lejojnë disa persona të shëtisin qentë sepse nuk do të jetë në nivelin e dëshiruar.

Te stërvitja në shkollat e futbollit me reflektorë, mendojmë se tarifa duhet të jetë 10 €, kurse te loja miqësore me klube jashtë qytetit kjo tarifë është e lartë, kurse te fusha në Dardani tarifat janë tejet të larta sepse fëmijët nuk kanë mundësi këtë ta përballojnë, prandaj ne si grup mendojmë që kjo tarifë të jetë 3-5 €, kurse për shfrytëzimin e fushës me reflektorë të jetë 10

Po ashtu do të doja ta dinim edhe për shfrytëzimin e sallave veç e veç, a është fjala për ndërtesën e rinisë apo për sallat e shkollave ?

Valentina Bunjaku-Rexhepi: fjala është për shtëpinë e rinisë, tarifat i keni të gjithë para vetes.

Selami Xhemajli: ne në mbledhjen e KPF-së i kemi dhënë përkrahje kësaj Rregulloreje dhe është fat i mirë që po promovohen këto tri projekte. Këto tarifa janë të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre, por besoj që duhet të specifikohen, p.sh. te staza e atletikës mujorja prej 5 € vlen vetëm për stadiumin ndihmës, kurse për lagjen Dardania besoj që nuk vlen.

Riad Rashiti: edhe ne si PDK e shohim një Rregullore e cila ka të meta dhe nuk është specifikuar ashtu siç duhet, prandaj ka mjaftë paqartësi. Po ashtu nuk shohim kategorizim të atyre shkollave të cilat bëjnë stërvitje të futbollit dhe nuk ka kategorizim të klubeve sportive të qytetit të Gjiilanit.

Në bazë të kësaj Rregullore është për t'u habitur se si kjo qeverisje vendos aq shpejtë tarifa, ende pa u bërë promovimi i terreneve sportive, kurse gjatë këtyre dy viteve Komuna nuk ka qenë aq e angazhuar që t'i realizoj kërkesat e klubeve sportive në Gjiilan.

Për ne këto tarifa duhet të jenë të kategorizuara, sepse nëse një shkollë e futbollit që ka 50 nxënës nuk duhet të paguaj njëjtë me një shkollë e cila ka 300 nxënës.

Te grup moshat 50 € për 3 orë është tarifë shumë e lartë dhe ne nuk e kemi të qartë në bazë të cilave vlerësime janë bërë këto propozime.

Nëse qëllimi i Komunës është që ta pasuroj buxhetin nga këto mjete, mendoj se është e dëmshme për kategorinë e sportistëve.

Për lojë miqësore me klubet jashtë vendit, nuk është treguar se për cilat fusha vlen kjo tarifa prej 50 €. Po ashtu tani aktualisht salla kryesore e sporteve në Gjilan, nuk e ka mënyrën e menaxhimit të terminëve ashtu siç duhet, sepse shihet edhe në subvencionet të cilat janë propozuar sot për t'i ndihmuar këto klube shihet se janë përkrahur më shumë klubet sipas shijes apo ato që i doni ju, prandaj klubet janë të diskriminuara në çdo aspekt. Për ne, këto çmime janë shumë të larta.

Shpresa Kurteshi: rregullorja si e tillë është shqyrtuar në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe kemi marrë të gjitha sqarimet nga përfaqësuesi i sektorit të sportit, i cili është prezent dhe kërkoj që ta merr fjalën. Ndoshta tarifat mund të duken të larta por janë të arsyeshme.

Ismet Hajdini: edhe unë mendoj se zyrtari i sportit duhet të na jap sqarime dhe arsyetime rreth këtyre tarifave.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: të gjitha klubet sportive që kanë pasur nevojë për subvencione kanë bërë kërkesë për subvencione dhe ne jemi të hapur dhe të barabartë për të gjithë. Për me tepër lus zyrtarin e sportit të na jep sqarime.

Malazog Hoxha: rregullorja është hartuar në bashkëpunim me Njësinë për Sport dhe Zyrën Ligjore duke u konsultuar në aspektin Juridik. Kjo Rregullore është dalë në dëgjim publik në çdo objekt sportiv të qytetit të Gjilanit. Të gjithë përfaqësuesit e Klubeve dhe Shkollave të futbollit, qytetarë dhe grupe të interesit kanë qenë prezent.

Ne jemi bazuar në këto tarifa, sepse të gjitha shkollat bëjnë gara në kuadër të lidhjes rajonale. Çdo shkollë e futbollit veç e veç e dinë saktë se sa e kanë numrin e nxënësve. Asnjë shkollë e futbollit qoftë edhe private nuk ka numër më të vogël se 100 nxënës. Çdo shkollë e futbollit përfiton nga prindërit e atyre fëmijëve minimum 1500-2000 € në muaj.

Gjatë dëgjimit publik, në përjashtim të Klubit “Gjilani” i cili është ankuar për këto tarifa, të gjitha shkollat tjera janë pajtuar për këto tarifa.

Tarifa për shfrytëzimin e stazës së atletikës për qytetarë ka për qëllim mirëmbajtjen e saj.

Isa Agushi: si duket Rregullorja paska kaluar në të gjitha procedurat e nevojshme. Është mirë që të hartohet një Rregullore e brendshme e cila do t'i precizoj gjërat më konkretisht.

Fehmi Sylejmani: sipas informatave që unë kam, nuk kanë qenë prezent të gjithë përfaqësuesit e shkollave të futbollit në dëgjim publik. Po ashtu në fushën e futbollit në lagjen Dardania nuk ka pasur dëgjim publik. Prandaj unë mendoj tarifa për fëmijë në këtë fushë është e lartë.

Në komitetet përkatëse ka anëtarë që janë edhe shërbyes civil dhe të gjithë e dimë që kjo nuk është e drejtë, sepse këtu krijohen konflikte apo ndikime për t'i kaluar këto propozime. Nëse doni unë i them me emra se cilët persona janë edhe anëtarë të komiteteve dhe shërbyes civil.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: është mirë që të na i thoni këta emra sepse ne nuk kemi njohuri të tillë, e nëse e keni fjalën për z. Malazog Hoxha ju njoftoj se ai nuk është shërbyes civil.

Fehmi Sylejmani: nuk desha t'i përmendi po ju po insistoni andaj ju them se edhe z. Malazog Hoxha tani është shërbyes civil dhe kjo është e paligjshme që të jetë edhe anëtarë i Komitetit, po ashtu në Komitetin e Pronës e keni është një shërbyes civil që punon ne DGJKP.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: z.Fadil Hajdari nuk është tani më shërbyes civil, sepse tani është këshilltarë i zëvendës Ministrit z.Izmi Zeka.

Bujar Nevzadi: unë personalisht nuk bindem për këto tarifa, sepse mendoj se janë të larta, sepse Komuna dhe ne si anëtarë të Kuvendit duhet të jemi më tolerant, sepse obligim i ynë është edukimi dhe largimi i të rinjve nga rruga. Prandaj, unë kërkoj që këto tarifa të lirohen dhe të bartin çmime simbolike se sa për t'i mirëmbajtur këto fusha.

Abdyl Aliu: u tha më parë nga kolegu se në debat publik nuk ka qenë klubi “Gjilani”, por unë ju them se në debate publike nuk kërkohet të ketë kuorum, por e rëndësishme është të ju dërgohet ftesa të gjithëve, kurse është e drejtë e klubeve se a dëshiron të marrë pjesë a jo.

Komuna nuk është e interesuar ta pasuroj buxhetin nga këto tarifa, por qëllimi është që mirëmbajtja të jetë në nivelin e duhur.

Përfitues janë klubet dhe të gjitha grupet e interesit, sepse ju kemi krijuar kushte të mira për punë. Më çudit fakti se kolegët merakosen për xhepin e klubeve.

Riad Rashiti: ne jemi kujdesur gjithmonë për investimet të cilat janë bërë, prandaj është mirë që të ngrihet zëri edhe nga pozita dhe të shikohet se a është në nivel mirëmbajtja e sallës së sportit.

Në qeverisjen tonë investimet kanë qenë më të mëdha se sot, stadiumi ndihmës është nisur në qeverisjen e PDK-së, projekti është bërë nga ne, donatorët i kemi gjetur ne, kurse ju e keni përruar me prerjen e shiritit. Po ashtu salla sportive në fshatin Malishevë, e shumë salla të tjera ne i kemi ndërtuar, kurse ju mirëmbajtjen e llogaritni problem.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: edhe projektin e varrezave e keni nisur ju, por ne e kemi kryer, po ashtu edhe shumë projekte i keni nisur e ne i kemi përfunduar dhe gjithçka që ju keni nisur ne do t'i përfundojmë, sepse nuk është adet të lihen gjërat në gjysmë e qytetarët të pësojnë, prandaj dikush nisë punët e dikush i përfundon.

Pasi nuk pati më diskutues Kryesuesja e Kuvendit e vë në votim Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 016-122568 e dt. 29.12.2015

Me 17 vota “për”, 8 vota”kundër” e të tjerat abstenime miratohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 016-122568 e dt. 29.12.2015

2.3. Informatë rreth organizimit të Manifestimit tradicional “Flaka e Janarit” 2016

Kryesuesja hapë debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Abdyl Aliu: sa ka zgjatur ky manifestim, unë kam pasur rastin që kohë pas kohe t'i përgëzoj organizatorët e këtij manifestimi. Edhe kësaj here flaka e janarit karakterizohet me avancim dhe me tendencat e mëtutjeshme të ngritjes dhe marrjes së një fizionomie ashtu siç duhet dhe siç e meritojnë dëshmorët.

Kemi pasurim të “Flakës” me elemente shumë domethënëse, ku nga një muaj i ftohtë, flaka e janarit krijon një muaj të ngrohët për të gjithë. E gjithë hapësira shqiptare, në muajin janar kthehet nga Gjilani. Manifestimi ka pasur shumë aktivitete, ne kemi vizituar FSK-në në Gjilan, vizitë në familjet e dëshmorëve dhe gjithçka ka ecur siç është më së miri.

Edhe shumë vite po të jetojmë, ne nuk mund t'i dalim hak dëshmorëve dhe familjeve të tyre, prandaj e vetmja mundësi që ata t'i nderojmë si duhet, është që ne të punojmë drejtë, të krijojmë kushte të mira për qytetarët e Kosovës dhe ta forcojmë e ta duam shtetin tonë.

Manifestimi Flaka e Janarit 2016, me gjithë programin e sajë, na ka bërë të ndihemi krenarë.

Bujar Nevzadi: ne edhe në fillim e kemi thënë, para se të filloj manifestimi "Flaka e Janarit", kur na është ofruar informata për bordin e saj, kemi thënë se keni bërë bord politik, kjo ka qenë risi, sepse Komuna e Gjilanit për herë të parë ka themeluar një bord politik.

Në mbledhjen e KPF-së, kam kërkuar që në seancë të na vij një raport analitik i shpenzimeve dhe ne nuk kemi pasur dhe nuk kam vërejtje në shumën e shpenzimeve, sikur ju që keni pasur më herët, për arsye se kam pasur fatin me qenë 20 vite anëtarë në bordin e Flakës së Janarit, nuk po e them se më ka mbetur merak pse tani nuk kam qenë anëtarë në bord, për arsye se kanë ardhur njerëz të rinj, por kam qenë kundër bordit kryekëput politik. Për çfarë arsye nuk keni sjellë një raport financiar analitik? Çfarë ka aty për t'u fshehur? Unë nuk po them se keni keqpërdorur diçka, por duhet të jeni transparent, prandaj mos ardhja e këtij raporti na bënë të dyshojmë se aty ka pasur keqpërdorime. Unë e di se sa shpenzime duhen për një manifestim të Flakës dhe nuk jemi kundër këtyre shpenzimeve. Bile mendoj se është dashur edhe më shumë të shpenzohet në këtë manifestim, por ju nuk sjellni kurrfarë raporti analitik të shpenzimeve. Po ashtu, sa i përket shpenzimeve të telefonit të Kryetarit të Komunës ai ka thënë se harxhoj vetëm 20€ dhe ne e kemi incizimin se çfarë ka thënë, kurse në letra del e kundërta.

Shpresa Kurteshi: rëndësia e Flakës tani më botërisht dihet. Informata e Flakës së Janarit është kërkuar nga Komiteti i Kulturës dhe aty është shqyrtuar në tërësi. Aty ka qenë edhe raporti financiar, mirëpo për shkak se ai raport nuk ka qenë i përmbyllur krejtësisht, ne kemi kërkuar që ky raport të përmbyllet dhe të sjellët prapë në Komitetin e Kulturës, e pastaj të përcillet në KPF. Raporti i tillë ekziston dhe besoj që do të jetë i pranishëm edhe për ju.

Flaka e Janarit për ata që e kanë përcjellë, ka pasur një vijueshmëri jashtëzakonisht të mirë, e për ata që nuk e kanë përcjellë nuk mund të jenë të informuar për çdo detaj. Elementet e reja që janë futur si fotoja e Flakës dhe Film Flaka, kanë qenë jashtëzakonisht të mirëpritura, sepse vetëm sa e kanë madhështua Flakën. Besoj që në seancën e radhës do të vije edhe Raporti financiar analitik.

Nevzat Isufi: ju e dini se para se të mbahet ky Manifestim tashmë i njohur për të gjithë, kanë ardhur shumë propozime dhe ne e kemi bërë një varg pyetjesh dhe propozime e sugjerime. Ky Manifestim as pas 25 viteve nuk e ka një Rregullore të veçantë, e cila do t'i kishte dhënë karakterin të cilin e ka pasur në të vërtetë e të cilën nuk e ka më të njëjtë. Meqë konsiderohet avancim dhe dhënie e ngjyrës partiake, unë mendoj se është gabim. Avancimi është dashur të vije pikërisht me një Rregullore të veçantë, prandaj jam i pajtimit që të specifikohet edhe ana financiare, por me vetë faktin që kanë kaluar 2 muaj të plotë dhe ne ende nuk e kemi atë raport, tregon se ne jemi mbrapa me kryerjen e detyrave tona që do të duhej të bëheshin.

Mendoj se edhe më tutje ka vend, që Manifestimi Flaka, të ruhet me ato kritere që i ka pas dhe mos t'i epen ngjyrimet partiake, sepse dëshmorët dhe atyre që i kushtohet nuk mund t'i ndajmë, sepse dëshmorët janë të të gjithëve.

Në anën tjetër e dimë që në atë Manifestim janë dhënë shpërblime, si në çdo Manifestim tjetër, por ka vërejtje nga të gjithë, për mënyrën e ndarjeve të shpërblimeve të këtij manifestimi, sepse para kohe është ditur se kush do të jetë fituesi.

Abdyl Aliu: nuk desha ta marr fjalën, por reagimet e kolegëve me detyruan të flas. Ne po flasim për një edicion jubilarë 25 vjetori i Flakës.

Unë e kam bërë një krahasim të 20 vjetorit të Manifestimit Flaka e Janarit dhe të 25 vjetorit të tij dhe në vitin 2011 kur Flaka ka pas 20 vjetorin, ajo kishte kushtuar 77.000 €, kurse 25 vjetori i tanishëm ka kushtuar 43.000 €.

Sa i përket bordit, e që e thatë se përbërja e saj ka qenë politike, unë kam emrat e bordit të vitit 2011 dhe ata janë: Bejtush Isufi, Hidajet Hyseni dhe Shemsi Sylja. Grupi Punues: Avdullah Behluli, Rustem Gjinolli dhe Hajrush Fazliu. Të shpërblyerit: Rustem Gjinolli.

Punimet e seancës vazhduan pas një pauze 5 minuta

Riad Rashiti: sinqerisht për këtë pikë të rendit të ditës nuk desha fare ta marr fjalën, por pasi po na nxisin kolegët nuk mund të mos flas.

Është e habitshme se ne si anëtarë të Kuvendit Komunal, nuk jemi në gjendje të nxjerrim një përqindje dhe me bë një krahasim të shifrave, me atë që z. Aliu bëri krahasime. Në 80 % i 77.000 € i bie se janë shpenzuar vetëm 16.000 €, prandaj është mirë të mësoheni të nxirrni përqindje, sepse kjo gjë për ne është shumë e thjeshtë.

Manipulimi i qytetarëve të Gjilanit me përbërjen e bordit të cilin e lexoi z. Aliu, ato kanë qenë përbërje për një aktivitet në kuadër të Manifestimit Flaka e Janarit. E din një Gjilan dhe një LDK dhe të gjitha subjektet e tjera politike, se në qeverisjen e PDK-së përbërjet e bordeve kanë pas përfaqësim të të gjitha subjekteve politike, por këtë vit kjo nuk ka ndodhur. Nuk ka ndodhur tragjedi që nuk ka ndodhur kjo, por mos shikoni që të zezat e juaja dhe keqpërdorimet e juaja t'i krahasoni me vitin 2011, sepse Festa e Flakës e vitit 2011 mbahet në mend aq mirë për organizimin e saj. Nëse ka qenë keq është dashur që ju të reagoni, sepse keni qenë opozitë në atë kohë, por ju nuk keni bërë asnjë lëvizje. Prandaj është mirë të mos manipuloni.

Projektin e Varrezave të Dëshmorëve, z.Abdyli e quajti njollë të zezë, por të thuhet një gjë e tillë është më shumë se e turpshme, sepse kjo LDK dhe LDD-ja e atëhershme për 7 vite nuk kanë pasur guxim ta mendojnë dhe ta qesin në letër një projekt për varrezat e Dëshmorëve në qytetin e Gjilanit.

Ka qenë PDK-ja e cila me konkurs ka zgjedhë projektin më të mirë, e ka nisur atë dhe ka mbetur pa përfunduar sikur edhe shumë projekte të tjera për arsye se nuk kemi pasur mbështetje financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne i kemi shprehë pakënaqësitë e tona dhe në atë kohë, që nuk kemi pasur mjete të mjaftueshme për t'i realizuar këto projekte.

Një gjë e turpshme të cilën ju po e arsyetoni është projekti i Lumit "Mirusha, për 7 vite ju nuk keni guxuar as ta diskutoni këtë projekt të cilin e keni qitë në letër dhe nuk keni pasur guxim ta filloni. Ne kemi pasur guxim ta fillojmë. Projekti i sahat Kullës, është nisë nga Ministria e Kulturës dhe e keni lënë në gjysmë sepse një projekt 80.000€ nuk keni qenë në gjendje ta përfundoni dhe në atë kohë Ministër ka qenë z.Lutfi Haziri dhe znj.Lirije Kajtazi.

Kryesuesja e Kuvendit i tërhoqi vërejtjen anëtarëve të Kuvendit që të flasin vetëm lidhur me rendin e ditës dhe të mos dalin jashtë saj, kurse në pikën të ndryshme mund të diskutojnë për ato që ju interesojnë.

Abdyl Aliu: kur është fjala te matematika dhe llogaritja e përqindjeve, unë jam ngutur dhe kam bërë llogaritje të gabuar, por dua të ju njoftoj se sot profesori im i matematikës është zgjedhur Rektor i Universitetit.

Arben Mehmeti: është njollë e freskët se kush ka dalë i turpshëm në këtë proces zgjedhorë z. Rashiti nuk ka të drejt të flasë për tema të tilla dhe të na akuzoj neve LDK-në.

Riad Rashiti: ne e kemi pranuar rezultatin zgjedhorë, por sot pas dy viteve qytetarët e Gjilanit po e shohin shumë mirë se kanë qenë të mashtruar aq shumë për premtimet që ju kanë bërë gjatë fushatës elektorale. Për 6 vite me qeverisje PDK-ja është krenare për mënyrën e qeverisjes, qoftë për investime, qoftë për menaxhim. Për ju është e turpshme sepse ende pa i bërë një vit akuzoheni për keqpërdorime nga institucionet e Drejtësisë.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: ju nuk jeni analist t'i analizoni gjërat se çfarë kemi bërë ne për dy vite qeverisje. Vlerësimet i bëjnë qytetarët, sepse ata i kanë parë punët e juaja se çfarë keni bërë, prandaj edhe ju kanë ndëshkuar. Nëse edhe ne nuk punojmë si duhet atëherë le të na ndëshkojnë edhe neve. Dhe ju lutem të mos diskutoni për gjëra që nuk janë në rendin e ditës, sepse tani jemi duke diskutuar për Manifestimin Flaka e Janarit 2016.

Nevzat Isufi: mendoj se ju si Kryesues, duhet t'i lejoni të gjithë të diskutojnë, sepse nëse njëri ka të drejtë të flas jashtë kësaj pike, atëherë edhe tjetri ka të drejtë të tillë. Sa i përket bordit të Flakës së Janarit në vitet e mëhershme, emrat të cilët i përmendi kolegu, do të ishte mirë që këta emra qoftë edhe si anëtarë nderi të ishin, për ta do të ishte respekt.

Abdyl Aliu: në Flakën e Janarit 2011, në bord ishin: Bejtush Isufi- Kryesues , Hidajet Hyseni, Shemsi Syla, Adhurim Rasimi. Akademinë e ka udhëhequr Adem Muji, Referues ishte Rexhep Qosja.

Pas këtyre diskutimeve Kryesuesja kaloi në pikën e radhës.

2.4. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në Gjiilan

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim nga anëtarët e Kuvendit dhe Kryesuesja e vë në votim pikën 2.4 të rendit të ditës.

Me 16 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe të tjerat abstenime u miratua Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në Gjiilan

2.5. Propozim vendimi për subvencionimin e aktiviteteve të Qendrës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve strehimorja “Liria” Gjiilan

Kryesuesja e Kuvendit hapë diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Nevzat Isufi: ju e dini se edhe në mbledhjen e KPF-së, unë kam pasur vërejtje konkrete rreth raportit financiarë dhe planit të kësaj qendre, sepse kërkesa, raporti dhe plani bëhet nga i njëjti person. Edhe anëtarët e tjerë të KPF-së kanë kërkuar që në këtë qendër të bëhet një Auditim, e pastaj kjo pikë të sillet në Kuvend.

Raporti dhe kërkesa nuk janë të sakta, p.sh. në raportin e barnave vërehet se në vitin paraprak nuk janë shpenzuar asnjë cent, kurse tani kërkohen 1.000 € për barna, prandaj kjo nuk e di si mund të arsyetohet. Po ashtu nuk është e mundur që faturat e Energjisë Elektrike të jenë me shpenzime zero. Për mua kjo gjë është e dyshimtë, prandaj do të ishte mirë që ky raport të jetë sa më serioz, apo të formohet një Komision i veçantë të monitoroj këtë punë.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: ne i kemi pranuar këto vërejtje edhe në mbledhjen e KPF-së, por kemi thënë se kësaj here do të bëjmë tolerime pasi që një gjë të tillë e kemi toleruar edhe me Klubet sportive, sepse kanë nevojë edhe Qendra “Liria” edhe klubet sportive, por unë mendoj se në vazhdimësi nga ky Kuvend do të themelohet një komision i cili do të monitoroj punën e këtyre shoqatave.

Nuk pati më diskutime dhe Kryesuesja e Kuvendit e vë në votim pikën 2.5 të rendit të ditës.

Me 18 vota “për”, asnjë “kundër” dhe të tjerat abstenime u miratua pika 2.5. Propozim vendimi për subvencionimin e aktiviteteve të Qendrës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve strehimorja “Liria” Gjiilan

Në vazhdim Kryesuesja e Kuvendit theksoi se pikën 2.6, 2.7, 2.8, 2.9, që kanë të bëjnë me subvencionimin e Klubeve Sportive t'i fusin në një pikë të vetme ashtu siç u propozua në fillim të seancës dhe për këto pika të diskutohet paralelisht.

- 2.6. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Drita”**
- 2.7. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Volejbollistik “Drita” F**
- 2.8. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Basketbollistik “Drita” M**
- 2.9. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Gjilani”**

Kryesuesja e Kuvendit hapë diskutim rreth këtyre pikave.

Fehmi Sylejmani: duke u bazuar në raportin të cilin ne e posedojmë, vërejmë se diku rreth 50.000 € janë të pa mbuluara, duke përfshirë klubet dhe individët të cilët i ka ndihmuar Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2015. Sidoqoftë, në bazë të shqyrtimeve të projektit të planeve financiare të klubeve të ndryshme sportive, e në këtë rast Klubin Futbollistik “Drita” vërehet se 134.730 € të parapara nga ky klub, Komuna ju ka lejuar 33.000€. Klubit të Volejbollit “Drita” (F) nga 65.500 € i ka lejuar 10.000€, Klubit Basketbollistik “Drita” nga 10.440€ i ka lejuar 8.000€, kurse Klubit Futbollistik “Gjilani” nga 54.855 €, i ka lejuar 30.000€. Duke ju referuar këtyre shifrave, pa dashur për anime, shihet se synimet e Klubit Futbollistik “Gjilani” në këtë rast kanë qenë më reale, sepse nga 54.855 € sa ata kanë kërkuar, ju kanë lejuar 30.000 €, për dallim nga Klubi Futbollistik “Drita” e cila ka kërkuar 134.730 € e të cilës ju kanë lejuar 33.000 €.

Kryesisht janë lejuar harxhimet që kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve për kuotizime, referë, transporte, pajisje mjekësore, pajisje sportive dhe rekuizita sportive. Të gjitha këto është dashur të arsyetohen me fatura përkatëse, harxhimet që kanë të bëjnë me pagesa të trajnerëve, lojtarëve, apo paga të tjera, në përgjithësi nuk janë përfshirë në subvencione, në përjashtim të disa klubeve.

Në shumën e përgjithshme të subvencioneve, janë përfshirë edhe dy punëtorë për mirëmbajtjen e stadiumit nga Klubi Futbollistik “Drita” dhe një punëtor nga Klubi Futbollistik “Gjilani”.

Nuk është mirë të kushtëzohen klubet rreth përfshirjes së punëtorëve sportiv nga Komuna në bilancet e subvencioneve të Klubit. Gjithashtu mendojmë se shuma e ndarë për Klubin Volejbollistik “Drita”(F) është paksa e zgjeruar, duke u bazuar në numrin e lojtarëve dhe stafit të këtij klubi, pavarësisht sukseseve të arritura, por është dashur që në formë të tjera të stimulohet ky Klub.

Këtu mungojnë ndihmat financiare për Klubet e Hendbollit sikurse edhe për Klubet e Sporteve luftarake, e ky është një lloj diskriminimi për këto klubeve sepse me çfarë baze nuk ju është rimarrë këtyre klubeve me vlera më të larta se 4.000€, kur dihet se dy Klubet e Hendbollit “Drita” dhe “Zhegra” në konkurrencën e meshkujve, garojnë në super ligë, madje këtë vit janë kualifikuar edhe në Play Of, teksa vitin e kaluar kanë përfituar nga Komuna, njëri Klub 4.000, kurse tjetri 3.500€.

Derisa Klubi Hendbollistik “Zhegra” gjysmën e mjeteve ka mundur t’i harxhoj vetëm për karburante për shkak të mungesës së sallës, është detyruar që stërvitjet dhe lojërat t’i zhvilloj në Gjilan. Ndërkohë kemi Klubin Basketbollistik “Drita” e cila ka rënë në nivel më të ulët se super liga dhe ju kanë lejuar 8.000€, kurse vitin e kaluar 10.000€, e kjo paraqet një ndarje të padrejtë dhe të pa barabartë, kur dihet se këto klube të Hendbollit përveç Seniorëve kanë edhe kategorinë e Pionierëve dhe Juniorëve.

Duhet pasur kujdes se me çfarë formule po ju ndihmoni këtyre Klubeve, derisa vitin e kaluar Klubi i Pingpongut vetëm për 900€ nuk ka mundur t’i vazhdoj garat dhe është shuar dhe për këtë shuarje kanë qenë në dijeni zyrtarët e mëhershëm të sportit të cilët nuk janë brengosur fare për vështirësitë e këtij klubi.

Prandaj ne si LVV kërkojmë që Komuna të mos ndajë ndihma në asnjë mënyrë për të gjitha klubet sportive, por gjithsesi të bëjë ndarje të drejtë, të barabartë dhe në bazë të prioriteteve të disiplinave sportive si dhe në cilin rang ajo garon, po ashtu të këmbëngul që çdo klub të japë llogari për mjetet e

harxhuara dhe të gjitha klubet që keqpërdorin këto mjete, të i ndalet rreptësisht mbështetja financiare dhe të ndëshkohen me dispozita ligjore.

Pa dashur për të ofenduar askënd, por në arsyetimin e këtyre klubeve, vërejmë se ka shumë keqpërdorime, madje ka edhe fryrje të çmimeve, dhe kjo vërtetë është shumë e çuditshme.

Unë propozoj që Kuvendi të formoj një Komision dhe t'i monitoron këto klube, sepse sipas informatave që i kam, shumë po i keqpërdorin mbështetjet financiare, madje disa klube është vetëm një person i cili menaxhon me të gjitha mjetet, duke mos përfituar asnjë lojtar nga këto mjete.

Klubet vërtetë meritojnë përkrahje të tilla, sepse në lojëra japin rezultate të mira, por shko e pyetni në Klubin e Hendbollit asnjë lojtarë nuk ka marrë asnjë cent.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: kur flitet për keqpërdorime, duhet të ketë argumente, por të pranishëm kemi zyrtarin për sport i cili na sqaron në detaje këtë punë.

Malazog Hoxha: ne kemi sjellë kërkesat e këtyre klubeve këtu në Kuvend dhe ndarja e subvencioneve mendoj se është bërë në mënyrën më të drejtë sepse të gjitha këto klubet janë tonat.

Klubi i Futbollit “Drita” dhe “Gjilani” gjithmonë na kanë bërë të ndihemi krenarë, e sidomos me organizimin e tifozëve të këtyre dy klubeve.

Në kuadër të marrëveshjes për subvencionimin e këtyre dy klubeve janë paraparë edhe punëtorët, dhe besoj që çdo qytetarë i Gjilanit e ndien vetën krenar se për çfarë terreni bëhet fjalë në Gjilan, sepse për tu bërë mirëmbajtja e këtij terreni, normalisht se edhe duhet stafi, prandaj kemi qenë të kujdesshëm që ky staf për punën dhe angazhimin që e bën të merr atë që e meriton.

Është e vërtetë që Klubi i Volejbollit ka lojtarë më pak dhe dihet se nuk krahasohet me Futbollin, por të gjithë ata që kanë qenë prezent në Prishtinë kur klubi i Volejbollit “Drita” (F) e ka fituar Kupën janë ndier shumë krenarë.

Sa i përket Klubeve të Hendbollit, nuk kemi dashur t'i anashkalojmë, por nga kjo sezon Federata e Hendbollit të Kosovës do t'i heqë të gjitha shpenzimet për personat zyrtarë, gjyqtarë dhe vëzhgues dhe kjo shumë arrin në 7.800 €.

Klubet Luftarake nuk kemi dashur t'i anashkalojmë as ato por nuk kemi mundur të gjitha t'i sjellim në Kuvend.

Fehmi Sylejmani: unë kam argumente se Klubi i Hendbollit “Zhegra” ka bërë kërkesë për ndihmë financiare në shumën prej 15.300 €, kurse Klubi i Hendbollit “Drita” ka kërkuar 8.000€, por arsyetimin e z. Hoxha e kuptoj dhe në njëfarë mënyre ka të drejtë, por kur flet për Hendbollin z. Hoxha ka harruar se klubet Futbollistike për të drejtat televizive i marrin 10.000 €, madje kanë sponsor që u japin donacione të mëdha.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: unë kërkoj sqarim nga z.Hoxha, se ku ka ardhur kërkesa e klubeve të Hendbollit dhe a jeni në dijeni ju për këto kërkesa ?

Malazog Hoxha: të gjitha klubet i kanë sjellë projektet e tyre me të cilat synohet të dalin në kampionat, në mesin e këtyre është edhe klubi Hendbollistik “Zhegra”, mirëpo me çfarë kërkesa vinë të gjitha klubet, neve na duhet një buxhet prej 1.000.000,00 €.

Isa Agushi: mendoj se të gjithë e dinë se fshati Zhegër i ka dy këshilltarë Komunal dhe klubi duhet të drejtohet te këshilltarët sepse për atë shkak ne jemi të zgjedhur. Nuk ka nevojë që ajo të orientohet diku tjetër, por unë atë klub e shoh politik dhe normal që nuk përfitojnë nëse nuk bashkëpunojnë. Në atë klub luan djali i vëllait tim dhe ata asnjëherë nuk kanë kërkuar një ndihmë edhe pse unë jam anëtarë i Kuvendit. Kjo nënkupton se nëse ata shkojnë në rrugë të tjera ilegale atëherë mbesin aty ku janë.

Pasi më nuk pati më diskutues Kryesuesja e Kuvendit i vë në votim pikat 2.6. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Drita”

2.7. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Volejbollistik “Drita” F

2.8. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Basketbollistik “Drita” M

2.9. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Gjilani”

Me 20 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe të tjerat abstenime miratohen pikat 2.6. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Drita”

2.7. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Volejbollistik “Drita” F

2.8. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Basketbollistik “Drita” M

2.9. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të Klubit Futbollistik “Gjilani”

2.10. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve.

Meqë nuk pati asnjë diskutues Kryesuesja e Kuvendit e vë në votim këtë pikë.

Me 22 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe të tjerat abstenime miratohet pika 2.10. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve.

3. Të ndryshme

Zijadin Maliqi: lidhur me të hollat që janë mbledhur për solidaritet, sipas jush duket se ato mjete janë zhdukur diku dhe le të hapen hetime, por në pauzën e kësaj seance unë isha në zyrën time dhe e shikova me detajisht raportin dhe në faqe 11 janë të shënuara participimet dhe donacionet, ku janë edhe këto mjete diku rreth 112.000€ apo saktësisht 111.989 €. Alokimi i tyre në vlerë prej 40.000 € është bërë në formë të subvencionit në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe 72.000€ janë në investimet kapitale.

Në faqen 16 janë mjetet e shpenzuara nga ato, e që janë pagesat e qirasë përmes DSHMS, kurse pjesa tjetër janë të bartura për vitin 2016.

U bisedua më parë se projektet i kemi nisur ne, e janë vazhduar nga ju, por kjo ndodhë gjithmonë, sepse dikush i nis e dikush i kryen.

Në vitin 2007 është nisur projekti të “Kodra e Djegur” dhe puna është kryer në këtë vit, në vitin 2008 PDK-ja e mori qeverisjen dhe në muajin shkurt të vitit 2008 u bë përfundimi i saj.

Nevzat Isufi: lidhur me emrat e bordit të Flakës së Janarit 2011, e njoftoj z. Aliun, se në bord kam qenë unë Nevzat Isufi e jo Bejtush Isufi.

Kam disa pyetje për drejtorët, se në bazë të procesverbalit, Parku “Dardania” është dashur të jetë në funksion deri më tani, prandaj çka ka ndodhur deri tani ? kur do të bëhet inaugurimi i parkut ?

Për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, dua ta pyes për donacionet, kur është themeluar dhe kush është udhëheqës i Bordit? A ka pranim teknik të objekteve që ndërtohen ? e shumë pyetje të tjera për të cilat asnjëherë nuk janë përgjigjur,

Çka ka ndodhur me tenderin e I-podëve?

Për DSHIP kam pyetje për hyrjet dhe daljet e rrugëve të qytetit, se a ka ndryshuar diçka projekti? dhe deri ku shkon zgjerimi i rrugës në drejtim të Kamenicës apo Bujanocit? A ka ndryshime të planit ? a është menduar që të ndërtohet një rreth rrotullim në rrugën që shkojmë për Prishtinë apo saktësisht te Pompat e Benzinës ?

Valentina Bunjaku-Rexhepi: përgjigjet do t'i merrni me shkrim z. Isufi.

Riad Rashiti: lidhur me transferin e mjeteve financiare për ndërtimin e shtëpive që e potencoi drejtori i DBF-së, unë nuk pajtohem me atë që e thotë dhe nuk mund t'i hedhim hi syve, sepse absolutisht nuk qëndron ashtu.

Kjo është Komuna e Gjilanit e cila me 28 shkurt ka dhënë deklaratë për media se 200.000€ janë të pa shfrytëzuara.

Drejtori i DBF-së thotë se në faqe 11 të raportit janë disa shifra, por nën tabelë është dorëshkrimi i donatorëve, "Save the children", "Unionu Evropian", "Qeveria Suedeze", "Care International", "Qeveria Daneze", dhe këtu nuk përmendet askund ajo që po e thuani ju i nderuari drejtor, prandaj për derisa këtu nuk përmendet një fjali e vetme, për mua dhe për të gjithë është e pa pranueshme dhe e pa qëndrueshme. Ju në raport nuk e keni paraqitur, por as nuk po e sqaroni se pse këto shifra nuk figurojnë askund. Andaj nuk mund ta arsyetoni në asnjë mënyrë, sepse ne po flasim për 200.000 e, kurse donatorët janë krejt të tjerë.

Abdyl Aliu: unë i kam të gjitha materialet e arkivuara në zyrën time, për gjithçka që flas, kam argumente me dokumente zyrtare, ky dokument është hartuar nga drejtori i asaj kohe i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport z. Selver Xhelili, Kryetari i Komunës ka qenë z. Qemajl Mustafa. Unë nuk mbaj në mend se kush ka qenë anëtar i bordit, por në dokumentacione figuron se kush ka qenë e kush jo.

Renan Imami: kam një pyetje për drejtorin e DSHIP, lidhur me rrugën "Nikolla Teslla" te "Kodra e Dëshmorëve" kur do të asfaltohet? sepse qytetarët kanë kërkesa të shumta për atë rrugë dhe ankohen vazhdimisht se të gjitha rrugët e tjera janë të asfaltuara, kurse vetëm ajo ka mbetur e pa asfaltuar.

Myzafere Ismajli: edhe unë kam një pyetje për drejtorin e DSHIP. Në rrugën "Gjon Sereçi", është ndërtuar një trotuar, por është shumë i lartë dhe disa parkingje aty fare nuk mund të shfrytëzohen, prandaj a do të dilni të shikoni atë pjesë dhe të ndërmerrni ndonjë veprim?

Arijeta Rexhepi: unë jam anëtare e Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në muajin e kaluar kemi pasur një mbledhje të jashtëzakonshme, lidhur me ndarjen e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë për të moshuar. Është kryer kjo mbledhje e jashtëzakonshme, edhe pse Komuna për këtë rast dhe për donatorin është e njoftuar që 7 muaj, kurse në planin e punës së Kuvendit është e paraparë në muajin mars, prandaj nuk është dashur të jetë mbledhje e jashtëzakonshme por e zakonshme. Në këtë muaj jemi ftuar për një mbledhje të këtij Komiteti, me pikë të rendit të ditës "Propozim Vendimi për zhvillimin e procedurave të ankandit publik, për dhënien në shfrytëzim të Pronës Komunale për ndërtimin e shtëpisë për të moshuar". Të nesërmen marrim njoftim se ky takim është anuluar. Andaj dua të informohem më gjerësisht, se ku qëndron puna apo problemi që bëhen këto ndryshime?

Valentina Bunjaku-Rexhepi: është caktuar mbledhje e Komitetit dhe e njëjta anulohet të nesërmen, sepse ka qenë problemi të dokumentacionet, me të cilat tani është duke u marr pala për kompletimin e

këtyre dokumentacioneve për ndërtimin e shtëpisë për të moshuar. Për të gjitha procedurat do të jeni në dijeni të gjithë.

Arijeta Rexhepi: lidhur dhe deponinë e qytetit në fshatin Velekincë, nga banorët e asaj ane, kemi vërejtje që kjo deponi është në gjendje të mjerueshme, nuk ka fare mirëmbajtje, prandaj kërkohet nga Komuna që të bëhet zgjidhja e këtij problemi dhe të përcillet kërkesa në organet kompetente.

Nevzat Isufi: këtyre ditëve ka qenë përvjetori i vdekjes së “Agim Rashiti” dhe sa herë që bëhen nderime në emër të institucioneve e sidomos në emër të Kuvendit, është mirë që edhe ne të njoftohemi për këtë çështje. Mos na anashkaloni, sepse ne nuk i ndajmë dëshmorët dhe duam që edhe ne të jemi prezent.

Valentina Bunjaku Rexhepi: keni të drejtë plotësisht z. Isufi, sepse kjo ka qenë një neglizhencë e imja, por ju premtoj që në të ardhmen do të jeni të njoftuar të gjithë për raste të tilla. Njoftimi do të jetë me sms personalisht nga unë.

Fehmi Sylejmani: meqë u përmend emri i të ndjerit, atëherë unë e kam një pyetje direkt. Pse u ndal turneu përkujtimor për dëshmorin “Agim Rashiti” ?

Valentina Bunjaku-Rexhepi: përgjigjen do ta merrni me shkrim.

Me këto debate dhe vendime seanca tretë i përfundoi punimet në ora 15.40 minuta.

Procesmbajtësja

Ardiana Rexhepi

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi